

OVLUÇK-ja kërkon
shkarkimin
e menjëhershëm
të Dimal Bashës I FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VOTIMI PËR NËNKRYETARIN SERB MBAN PENG KONSTITUIMIN E KUVENDIT I FAQE 4-5



Deputetët u mbledhën sërish të enjten për ta përmbyllur konstituimin e Kuvendit me zgjedhjen e nënkryetarit të pestë dhe të fundit të tij. Megjithatë, ata dështuan sërish ta votonin nënkryetarin nga pakica serbe, duke e nxitur

kryetarin e Kuvendit, Dimal Basha, ta ndërpriste seancën. Lista Serbe nuk hoqi dorë nga kandidimi i Sllavko Simiqit për nënkryetar, pastaj Basha i hodhi në votim përmes shortit pesë prej nëntë deputetëve të saj. Secili prej tyre

mori zero vota. Eugen Cakolli nga KDI-ja ka thënë se po bëhet gjithnjë e më e qartë se vendi po shtyhet me vetëdije drejt një krize të re kushtetuese, edhe më të thellë se ajo për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit

**BASHA
DISTANCOHET
NGA ARTIKULLI
KUNDËR
UÇK-së F. 7**



**PROKURORIA E
PEJËS ORGANIZON
TAKIM ME
INSTITUCIONET
KOMPETENTE
PËR MBROJTJEN
E TË DREJTAVE TË
FËMIJËVE F. 5**



AKTUALE



**SAVE THE CHILDREN: FËMIJËT E
URITUR NË GAZË NUK KANË FORCË
AS TË QAJNË F. 2**

**MENAXHMENTI I RTK-SË:
RIORGANIZIMI I STAFIT S'KA
KARAKTER NDËSHKUES F. 6**

**AGK-JA DËNON SULMET NDAJ
GAZETARËVE NGA
KRYEPARLAMENTARI BASHA F. 7**

EKONOMI



**ÇMIMET E IMPORTIT MË TË LARTA
NË TREMUJORIN E DYTË 2025
SESA NË ATË TË 2024 F. 8**

**KRYETARI LATIFI VIZITOI
BODRUMET "LABI WINE",
SHEH SUKSESIN DHE KUSHTET
E OPERIMIT F. 8**

SPORT



**TRAJNER I ZVICRËS: JEMI TË
ZHGËNJYER SE LEON AVDULLAHU
E ZGJODHI KOSOVËN F. 10**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net / www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Save the Children: Fëmijët e uritur në Gazë nuk kanë forcë as të qajnë

GAZA, 28 GUSHT - Udhëheqësja e organizatës për të drejtat e fëmijëve, Save the Children, ka përshkruar në detaje tronditëse agoninë e ngadalhtë të fëmijëve të uritur në Gazë, duke thënë se ata janë aq të dobët fizikisht sa nuk mundën as të qajnë.

Duke iu adresuar mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara lidhur me konfliktin izraelito-palestinez, presidentja e kësaj organizate ndërkombëtare bamirëse, Inger Ashing, tha se zia e bukës - që javën e kaluar OKB-ja tha se po ndodh në Gazë - nuk është vetëm term teknik. "Kur nuk ka ushqim të mjaftueshëm,



fëmijët vuajnë nga kequshqyerja akute dhe më pas vdesin ngadalë dhe në dhimbje. Kjo, thënë qartë, është ajo çfarë është zia e bukës",

tha Ashing.

Më pas ajo përshkroi se çfarë ndodh kur fëmijët vdesin nga zia e bukës, proces që sipas saj zgjat

disa javë. Trupi, tha Ashing, fillimisht shfrytëzon yndyrën e vet për të mbijetuar, por kur nuk ka më yndyrë trupore, trupi nis të konsumojë vetveten, duke përdorur muskujt dhe organet vitale. "Megjithatë, klinikat tona janë pothuajse të heshtura. Fëmijët nuk kanë forcë as të flasin e as të qajnë në agoninë. Ata shtrihen, të dobët fizikisht, duke vdekur" ngadalë, tha Ashing. Ajo insistoi se grupet e ndihmës me zë të lartë kanë paralajmëruar për zinë e urisë, kur Izraeli ndaloi që ushqimet dhe gjërat e tjera esenciale të hynin në Gazë, gjatë luftës. "Të gjithë në këtë mbledhje

kanë përgjegjësi morale dhe ligjore që të veprojnë që ta ndalin këtë mizori", tha Ashing.

OKB-ja shpalli zyrtarisht zinë e bukës në Gazë javën e kaluar, duke fajësuar atë që e quajti pengesë sistematike të ndihmave nga Izraeli gjatë më shumë se 22 muajsh luftë.

Organizata që monitoron urinën, e quajtur Klasifikimi i Integruar i Fazave të Sigurisë Ushqimore, apo IPC, tha se zia e bukës po prek 500.000 njerëz në Qytetin e Gazës dhe deri në fund të shtatorit uria do të përhapet në rreth dy të tretat e tërë territorit palestinez.

Të paktën 14 të vrarë dhe 48 të plagosur nga një sulm i madh rus në Kiev

KIEV, 28 GUSHT - Të paktën 14 njerëz janë vrarë dhe 48 të tjerë janë plagosur nga një sulm i madh rus me dronë dhe raketa në kryeqytetin e Ukrainës mëngjesin e së enjtes, njoftuan autoritetet lokale.

Rusia e kreu këtë sulm të madh në një kohë kur përpjekjet e udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara për t'i dhënë fund luftës mbi trivjeçare po hasin vështirësi. Tre fëmijë, fëmijë të moshës 2, 14 dhe 17 vjeçe, janë në mesin e të vrarëve, tha Tymur Tkachenko, kreu i administratës së qytetit të Kievit.

Numri i viktimave pritet të rritet teksa ekipet për shpëtim po

punojnë në vendngjarje për t'i nxjerrë njerëzit e mbetur nën rrënoja. "Rusia i zgjedh raketat balistike në vend të tryezës së bisedimeve", tha presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, në një postim në X pas sulmit. "Ne presim reagim nga të gjithë ata që kanë bërë thirrje për paqe nga e gjithë bota, por që sot gjithnjë e më shpesh po heshtin në vend se të mbajnë qëndrim parimor", theksoi Zelensky.

Rusia përdori dronë mashtrues, raketa lundruese dhe raketa balistike, tha Tymur Tkachenko, kreu i administratës së qytetit të Kievit.

Të paktën 20 zona në shtatë

rajone të Kievit u goditën. Pothuajse 100 ndërtesa u dëmtuan, përfshirë një qendër tregtare në qendër të qytetit, dhe mijëra dritare u thyen, tha ai.

Si pasojë e sulmeve ruse, zyra e "Radios Evropa e Lirë" në Kiev pësoi dëmtime. Dritaret e disa hapësirave të redaksisë u thyen, ndërsa u dëmtua edhe një pjesë e pajisjeve teknike. Të plagosur nuk ka.

Sulmet ruse goditën pjesën qendrore të Kievit, një nga rastet e rralla që sulmet kanë depërtuar thellë brenda kryeqytetit ukrainas që prej fillimit të pushtimit në shkallë të plotë në shkurt 2022.



Sulmi i së enjtes është sulmi i pari i madh dhe i kombinuar me dronë dhe raketa që Rusia e kryen në Kiev që prej takimit të presidentit amerikan, Donald

Trump, me presidentin rus, Vladimir Putin, në Alaskë në fillim të këtij muaji, për të diskutuar përfundimin e luftës në Ukrainë.

Kim Jong Un dhe Putin do të marrin pjesë në një paradë ushtarake në Kinë javën e ardhshme

PEKIN, 28 GUSHT - Lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, do të udhëtojë në Kinë për herë të parë pas gjashtë vjetësh, për të marrë pjesë në një paradë ushtarake javën e ardhshme, njoftuan të dyja vendet të enjten.

Kim dhe presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, do të jenë mesin e 26 liderëve të huaj që do të marrin pjesë në paradën e 3 shtatorit në Pekin, për të shënuar 80-vjetorin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe qëndresës së Kinës ndaj agresioneve të Japonisë gjatë luftës, sipas Ministrisë së Jashtme të Kinës. "Ne e mirëpresim ngrohtësisht sekretarin e përgjithshëm Kim Jong Un në Kinë, për të marrë pjesë në aktivitetet përkujtimore", tha Hong Lei, zëvendësministër i jashtëm i Kinës, në një konferencë për shtyp.

Agjencia shtetërore e lajmeve e Koresë së Veriut, KCNA, tha se



Kim do ta vizitojë Kinën me ftesë të presidentit kinez, Xi Jinping, për të marrë pjesë në festimet e 80-vjetorit të përfundimit të luftës.

Në mesin e të ftuarve të tjerë janë edhe liderët e Iranit, Bjellorusisë, Serbisë, Kubës, Indonezisë, Mianmarit, Pakistanit dhe Malajzisë.

Asnjë lider nga Shtetet e

Bashkuara apo vendet kryesore të Evropës Perëndimore nuk pritet të marrë pjesë, kryesisht për shkak të mosmarrëveshjeve me Putinin mbi luftën në Ukrainë.

Në paradë pritet të shfaqen disa nga armët më të reja të Kinës, ku gjithashtu Xi do të mbajë fjalim. Nëse udhëtimi i Kimit realizohet, ai do të jetë udhëtimi i tij i parë

në Kinë që nga viti 2019.

Prej se e mori pushtetin pas vdekjes së babait të tij në dhjetor të vitit 2011, Kimi është takuar me Xinë, Putin, presidentin amerikan Donald Trump, ish-presidentin e Koresë së Jugut, Moon Jae-in, dhe të tjerë, por të gjitha këto takime kanë qenë dypalëshe dhe ai nuk ka marrë pjesë kurrë në ngjarje shumëpalëshe me liderë të huaj. Në përgjithësi, Kimi udhëtoi katër herë në Kinë nga viti 2018 deri në vitin 2019 për t'u takuar me Xinë.

Kina është tash e një kohë të gjatë partneri më i madh tregtar i Koresë së Veriut dhe furnizuesi kryesor i ndihmave, megjithatë në vitet e fundit janë ngritur dyshime mbi marrëdhëniet mes tyre.

Koreja e Veriut është përqendruar në zgjerimin e bashkëpunimit me Rusinë, duke dërguar trupa dhe municione për ta mbështetur luftën e

Moskës në Ukrainë, në këmbim të ndihmës ekonomike dhe ushtarake.

Megjithatë, shumë analistë thonë se Koreja e Veriut pritet të ndërmarrë hapa për t'i përmirësuar marrëdhëniet me Kinën, në mënyrë që ta ringjallë ekonominë e saj të dobësuar, sepse ka një kufi për atë që mund ta marrë nga Rusia dhe mbetet e paqartë nëse bashkëpunimi me Moskën do të vazhdojë me të njëjtin ritëm pas përfundimit të luftës në Ukrainë.

Vizita e Kimit në Kinë mund të lidhet gjithashtu me përpjekjet për të rifilluar diplomacinë me Trumpin, i cili ka theksuar shpesh marrëdhënien e tij me Kimin dhe ka shprehur shpresat për të rinisur bisedimet. Koreja e Veriut deri tani kundërshtuar qasjen e Trumpit, por shumë analistë thonë se ajo mund të rikthehet në bisedime nëse beson se ShBA-ja do të bëjë lëshime më të mëdha.

OVLUÇK-ja kërkon shkarkimin e menjëhershëm të Dimal Bashës

PRISHTINË, 28 GUSHT - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka kërkuar shkarkimin e menjëhershëm të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, lidhur me bashkëautorësinë e tij në një artikull që shkruan kundër UÇK-së. Në një konferencë për medie, OVLUÇK-ja ka bërë thirrje që

institucionet e vendit të ndërmarrin menjëherë shkarkimin e Bashës, si dhe të nisë një hetim nga Prokuroria e Shtetit të Kosovës. “Kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së kërkojmë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës që të shkarkojnë menjëherë Dimal Bashën dhe të nisin hetimet nga Prokuroria. Arsyeja për këtë kërkesë është e qartë,

pjesëmarrja në fushata propagandistike kundër UÇK-së dhe Kosovës, si dhe lidhjet personale dhe bashkëpunimi me persona të dyshimtë, përfshirë bashkëpunëtorë nga Maqedonia e Veriut, që cenojnë integritetin tonë. Nëse kërkesat tona nuk merren parasysh, do të ndërmarrim masa të tjera, për të cilat do t’ju njoftojmë në kohë”, ka thënë Gucati.



ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PRESIDENCIALE NË REPUBLIKËN SËRPSKA ÇAKTOHEN PËR 23 NËNTOR

SARAJEVË, 28 GUSHT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Bosnjë dhe Hercegovinës ka shpallur zgjedhjet e parakohshme për president të Republikës Sërpska (RS) më 23 nëntor. Kjo pozitë në entitetin serb mbeti e lirë pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ia hoqi mandatin Millorad Dodikut më 18 gusht, në bazë të një vendimi të formës së prerë të Gjykatës së Bosnjë dhe Hercegovinës, me të cilin ai u dënua me një vit burg dhe gjashtë vjet ndalim për ushtrimin e funksioneve publike për shkak të moszbatimit të vendimeve të përfaqësuesit të Lartë ndërkombëtar. Dodik refuzon të tërhiqet nga kjo pozitë. Ndërkohë, Kuvendi i Republikës Sërpska ka miratuar një sërë ligjesh dhe konkluzioneve jokushtetuese që lidhen me mbajtjen e një referendumi në këtë entitet të Bosnjë e Hercegovinës, në të cilin qytetarët do të duhej të shpreheshin për aktgjykimin e Gjykatës së Bosnjë e Hercegovinës kundër Dodikut dhe për vendimin e KQZ-së së Bosnjës me të cilin atij iu hoq mandati i presidentit të RS-së. KQZ-ja e Bosnjës ka marrë vendim që të shpallen zgjedhjet e parakohshme për presidentin



e RS-së, pasi dy nënkryetarëve (një boshnjak dhe një kroat) nuk u janë hequr mandatet. Në mbledhjen e KQZ-së është miratuar gjithashtu përfundimi që lista qendrore e votuesve të mbyllet më 27 gusht të këtij viti në orën 00:00. Të drejtë vote, sipas listës zgjedhore, kanë rreth 1 milion e 266 mijë votues. Për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme për presidentin e Republikës Sërpska është e nevojshme të ndahen 6 milionë e 490 mijë marka (rreth 3.2 milionë

euro). Bosnja dhe Hercegovina ende nuk ka buxhet të miratuar dhe shteti funksionon me buxhet të përkohshëm. Presidenca në Bosnje më 19 gusht ka dorëzuar projekt-buxhetin, ku është paraparë edhe financimi për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në RS. Që të hyjë në fuqi, buxheti duhet të miratohet edhe në të dyja dhomat e Parlamentit të Bosnje e Hercegovinës.

Të gjithë qytetarët në moshë madhore me vendbanim të regjistruar në entitetin e Republikës Sërpska, të cilët figurojnë në listën zgjedhore, mund të votojnë për presidentin e këtij entiteti. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Bosnjës menaxhon me listën e votuesve. Qytetarët mund në çdo kohë të kontrollojnë nëse janë të regjistruar, ku ndodhet vendvotimi i tyre, si dhe të kërkojnë regjistrim ose fshirjen,

për shembull, të personave të vdekur nga lista zgjedhore.

Kush do t'i organizojë zgjedhjet?

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Bosnjës dhe Hercegovinës është organi përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e të gjitha zgjedhjeve në Bosnje - të përgjithshme, lokale dhe të parakohshme. Përfaqësuesi i Lartë në Bosnje, Christian Schmidt, në mars 2024 ka zgjeruar kompetencat e KQZ-së përmes ndryshimeve në Ligjin Zgjedhor të Bosnjës. Me këto ndryshime, KQZ-ja fitoi të drejtën të emërojë anëtarët e këshillave të vendvotimeve, të cilët vetëm në zgjedhjet lokale të atij viti ishin mbi 12.000. KQZ-ja përveç pranimi të kandidaturave, do të duhet të organizojë edhe pjesën teknike: shtypjen e fletëvotimeve dhe vendosjen e pajisjeve për identifikim elektronik të votuesve dhe numërim elektronik të votave. Ky sistem pritet të zbatohet plotësisht në gjithë Bosnjën dhe Hercegovinën deri në zgjedhjet e rregullta të përgjithshme në tetor 2026.

Gjykata Supreme rrëzon ankesën e kandidatit të PDK-së për Deçan, Korab Mushkolaj

PRISHTINË, 28 GUSHT - Gjykata Supreme ka hedhur poshtë ankesën e kandidatit të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të Deçanit, Korab Mushkolaj, kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pasi këtij të fundit iu refuzua certifikimi për zgjedhjet e 12 tetorit. Në vendimin e Supremes thuhet se ankesa e Mushkolajt është “e pa themeltë”, duke konfirmuar konstatimin e PZAP-së dhe Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe

Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike. Kjo e fundit kishte refuzuar certifikimin e kandidaturës së Mushkolajt, pasi ai është i angazhuar me aktemërim të përhershëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme si zyrtar i lartë - çka bie ndesh me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm, i cili ndalon kandidimin e anëtarëve të këtij shërbimi. PDK-ja kishte refuzuar kërkesën që ta zëvendësonte Mushkolajn me një kandidat tjetër, ndërsa pjesa tjetër e listës është certifikuar pa

pengesa. Gjykata Supreme ka theksuar se moscertifikimi i Mushkolajt nuk është i kundërligjshëm dhe se nuk përbën diskriminim apo cenim të së drejtës së tij për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur. “Vendimi është i drejtë dhe nuk janë shkelur as parimet themelore të procesit zgjedhor e as të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, thuhet në aktvendimin e Supremes.





VOTIMI PËR NËNKRYETARIN SERB MBAN PENG KONSTITUIMIN E KUVENDIT

Deputetët u mbledhën sërish të enjten për ta përmbyllur konstituimin e Kuvendit me zgjedhjen e nënkryetarit të pestë dhe të fundit të tij. Megjithatë, ata dështuan sërish ta votonin nënkryetarin nga pakica serbe, duke e nxitur kryetarin e Kuvendit, Dimal Basha, ta ndërpriste seancën. Lista Serbe nuk hoqi dorë nga kandidimi i Sllavko Simiqit për nënkryetar, pastaj Basha i hodhi në votim përmes shortit pesë prej nëntë deputetëve të saj. Secili prej tyre mori zero vota. Eugen Cakolli nga KDI-ja ka thënë se po bëhet gjithnjë e më e qartë se vendi po shtyhet me vetëdije drejt një krize të re kushtetuese, edhe më të thellë se ajo për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINE, 28 GUSHT - Deputetët u mbledhën të enjten për ta përmbyllur konstituimin e Kuvendit me zgjedhjen e nënkryetarit të pestë dhe të fundit të tij. Megjithatë, ata dështuan sërish ta votonin nënkryetarin nga pakica serbe, duke e nxitur kryetarin e Kuvendit, Dimal Basha, ta ndërpriste seancën.

Pasi Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë që e gëzon edhe mbështetjen e Beogradit zyrtar nuk hoqi dorë nga kandidimi i Sllavko Simiqit për nënkryetar, kryetari Basha i hodhi në votim përmes shortit pesë prej nëntë deputetëve të saj.

Secili prej tyre mori zero vota. Më pas, shorti i ra Nenad Rashiqit, deputetit tjetër serb në Kuvendin e Kosovës, i cili nuk përkrahet nga Lista Serbe. Rashiq është kryetar i partisë serbe Për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, dhe njëri i afërt me kreun e Lëvizjes Vetëvendosjes

dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti.

Rashiq, i cili nuk ishte votuar as në seancën e kaluar i mori 56 vota për, 1 kundër, ndërsa 20 deputetë abstenuan. Kjo nënkupton se Rashiq ka të drejtë të nxirret në votim vetëm edhe një herë.

Basha tha se e ndërpreu seancën për t'i thirrur në diskutime partitë e tjera parlamentare për ta votuar Rashiqin. "Sa për njohurinë tuaj, jeni edhe dëshmitarë, [Rashiq] është i vetmi deputet që po merr më së shumti vota për. Pra, teoria e gjasave që të zgjidhet nga komuniteti serb, gjasat më të mëdha i ka Nenad Rashiq, prandaj unë e mbylli këtë seancë këtu dhe i vazhdojmë diskutimet mes grupeve parlamentare që ta votojnë deputetin Nenad Rashiq", tha ai.

Ndërkaq Kuvendi i Kosovës ka njoftuar se vazhdimi i seancës konstituive do të bëhet të shtunën në orën 11:00.

Deputeti i Listës Serbe, Igor Simiq,

ka thënë pas seancës së Kuvendit të Kosovës se po shkelen të drejtat themelore të njeriut të komunitetit serb, rendi kushtetues dhe Rregullorja e punës së Kuvendit.

Për këto shkelje të pretenduara, Lista Serbe njoftoi se do të parashtojë ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

Një nga pesë nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës i takon pakicës serbe, sipas Kushtetues së Kosovës.

Eugen Cakolli nga KDI-ja ka thënë se po bëhet gjithnjë e më e qartë se vendi po shtyhet me vetëdije drejt një krize të re kushtetuese, edhe më të thellë se ajo për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit. "Me konsumimin procedural të të gjitha kandidaturave të mundshme nga radhët e komunitetit serb - sado që vetë procedura e ndjekur nuk është në harmoni me aktgjykimet e Kushtetueses - pas seancës së ardhshme, Kuvendi mund të mos

ketë më as për çka të mblidhet, pasi nuk do të ketë më asnjë kandidat që mund të propozohet. E gjithë kjo situatë, si rezultat i devijimeve procedurale dhe shkeljes së aktgjyimeve të Gjykatës Kushtetuese nga kryetari i Kuvendit, do të përfundojë ose si rast i ri në Kushtetuese, ose eventualisht me zgjedhje të reja pas skadimit të afatit 30-ditor, varësisht prej përfundimit të shqyrtimit të kërkesës së dërguar nga presidentja", ka thënë ai.

Cakolli ka theksuar se nëse do të kemi inicim të një rasti të ri kushtetues, përveç humbjes së disa javëve apo muajve, skenari më i mirë do të ishte anulimi dhe rikthimi i procedurës në pikën zero, duke u kthyer te praktika e votimit të nënkryetarëve të komuniteteve në pako. "Por në rastin më të keq të mundshëm, rrezikohet një precedent që kodifikon një lloj shumice të dyfishtë për propozimin dhe zgjedhjen e nënkryetarëve nga radhët e komuniteteve - skenar që duhet shmangur me çdo kusht", ka thënë Cakolli.

AAK-ja: Adem Hoxha nuk është më pjesë e grupit tonë parlamentar

Edhe pse grupet parlamentare ende nuk janë zyrtarizuar, Time Kadrijaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës konfirmoi se deputeti goran, Adem Hoxha, nuk do të jetë pjesë e këtij grupi,

ndryshe nga sa ishte raportuar më herët.

Arsyeja është se ai votoi kundër qëndrimit të grupit, duke i dhënë votën një kandidati nga Lista Serbe për nënkryetar të Kuvendit.

Adem Hoxha më herët ka qenë pjesë e grupit parlamentar të Listës Serbe. Nëse i bashkohet sërish kësaj liste, ajo do të ketë gjithsej 10 deputetë në Kuvendin e Kosovës.

Hekuran Murati: Nëse jo Rashiq, kush duhet të zgjidhet nënkryetar nga pakica serbe

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, i ka kritikuar

Komisioni për Çështje Normative finalizon draftin e Rregullores për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë të Këshillit Prokurorial

Prishtinë, 28 gusht - Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga Arian Gashi, në përbërje me anëtarët Bahri Hyseni dhe Ilir Morina, si dhe drejtori i përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, ka mbajtur takimin e radhës, ku është trajtuar procesi i shqyrtimit të komenteve të pranuar gjatë fazës së dëgjimit publik lidhur

me draftin e Rregullores për Zgjedhjen e Anëtarëve Prokurorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Gjatë këtij takimi, Komisioni ka shqyrtuar me kujdes komentet e paraqitura nga përfaqësues të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, të cilët ishin të pranishëm në takimin e së enjtes. Pas analizës së këtyre komenteve janë bërë

ndryshimet përkatëse në draftin e rregullores, me qëllim të përmirësimit të mëtejshëm të dokumentit dhe përputhjes së tij me standardet më të mira institucionale. Komisioni ka vendosur që drafti i finalizuar i Rregullores të procedohet për shqyrtim dhe miratim në një nga takimet e ardhshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



URAN ISMAILI: TRANSPORTI PUBLIK DO TË JETË FALAS PËR TË GJITHË QYTETARËT NË PRISHTINË



PRISHTINË, 28 GUSHT - Kandidati për kryetar të Prishtinës, Uran Ismaili, është zotuar se gjatë mandatit të tij do të mundësojë transport publik falas për të gjithë banorët e kryeqytetit. “Kemi me e mundësu transportin publik falas për gjithë banorët e Prishtinës deri në fund të mandatit”, ka deklaruar Ismaili në videon e ndarë në rrjetet e tij sociale. Ky zotim është pjesë e paketës së tij me 5 zgjidhje për Prishtinën, në kuadër të planit për zhblokimin e trafikut - një nga problemet më të mëdha të kryeqytetit. Ismaili ka theksuar se që nga viti 2016 nuk është blerë asnjë

autobus i ri në Prishtinë, ndërsa shumë lagje mbesin ende të papërfshira nga linjat urbane ose pa stacione e pritore funksionale. Përveç transportit falas, plani i tij përfshin: 100 autobusë të rinj për mbulimin e të gjitha lagjeve të Prishtinës; Korsi të dedikuara për autobusë, që do të mundësojnë qarkullimin çdo 7 minuta; Rinovim të stacioneve me ulëse, ndriçim dhe tabela dixhitale informuese. Sipas Ismailit, këto masa do të kthejnë transportin publik në një shërbim funksional e të besueshëm për qytetarët e kryeqytetit.

PROKURORIA E PEJËS ORGANIZON TAKIM ME INSTITUCIONET KOMPETENTE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

PEJË, 28 GUSHT - Në Prokurorinë Themelore në Pejë është mbajtur takim ndërinstitutional për trajtimin e rasteve për të mitur, me theks të veçantë aplikimi i masës së diversitetit “Vërejtja policore”, ku në këtë takim ishte i pranishëm u.d Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, kryeprokurorja e kësaj prokurorie, Lumturije Vuçetaj, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Gjakovës, Enis Gashi, koordinatoreja e veprave penale kundër integritetit seksual, prokurorja e shtetit, Sanije Gashi Seferi, drejtori i Drejtorisë

Rajonale të Policisë në Pejë, kolonel Shaban Shala, përfaqësues qendror dhe rajonal të Policisë së Kosovës, si dhe përfaqësuese tjerë institucional. Ky takim me iniciativën e prokurores koordinatorë të veprave penale kundër integritetit seksual ka pas për objekt, ngritjen e nivelit ndërinstitutional me qëllim të harmonizimit të veprimeve të sigurimit të provave nga vendi i ngjarjes dhe aplikimin e masës së diversitetit “Vërejtja policore”, masë e cila për herën e parë është aplikuar nga Prokuroria

Themelore e Pejës. Kjo masë e diversitetit u tha se do shërbejë si shembull edhe për institucionet tjera në Republikën e Kosovës, si masë e cila shkon në interesin me të mirë të miturve, ashtu siç e parash Kodi i Drejtësisë për të Mitur. Gjatë këtij takimi, u diskutua edhe për identifikimin e hapave të mëtutjeshëm në parandalimin e veprave kundër integritetit seksual dhe adresimin e sfidave në fushën e sigurisë publike me theks të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe fëmijëve si kategoria me e ndjeshme e shoqërisë.



partitë politike që kanë qenë në opozitë në legjislaturën e kaluar, PDK, LDK dhe AAK e Nisma, për mosvotimin e Nenad Rashiqtë nënkryetar të Kuvendit të Kosovës. “Nuk e kuptojmë cili është qëllimi i deputetëve të opozitës, ku një pjesë abstenon, siç janë deputetët e PDK-së dhe AAK dhe NISMA, ndërsa ata të LDK nuk merr pjesë në votim”, tha Murati për gazetarë.

Ai tha se dëshiron t'i pyesë ata se, “nëse jo Nenad Rashiq, kush nga pakica serbe duhet të zgjidhet nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, sipas tyre”. “Besoj këtë pyetje duhet t’ua bëjmë atyre vazhdimisht deri në seancën e ardhshme”, shtoi ai.

Krasniqi: Vetëvendosje do vazhdimin e bllokadës

Kryetari i partisë së dytë më të

madhe në Kuvendin e Kosovës, PDK, Memli Krasniqi, e ka akuzuar partinë fituese të zgjedhjeve, Lëvizja Vetëvendosje, se “dëshiron” ta vazhdojë ngërçin politik. Duke folur pas dështimit të radhës për ta konstituuar Kuvendin, Krasniqi tha për gazetarë: “Ju po e vëreni që ka një tentim për të mos shkuar tutje me konstituimin e Kuvendit, por çfarë më befason mua është fakti se si krejt

Vetëvendosja, nga Kurti deri te deputeti i fundit, po angazhohen për ta bërë nënkryetar një deputet të komunitetit serb, që, nëse e krahasoj, shumë më pak janë angazhuar për Albulena Haxhiun apo Dimal Bashën”. Krasniqi shpjegoi se deputetët e partisë së tij po abstenojnë nga votimi për Rashiqin, “sepse mënyra e votimit është jokushtetuese”. “Ajo çfarë e ka karakterizuar sjelljen e

Vetëvendosjes nga 15 prilli është veprimi jokushtetues dhe këtë e ka dëshmuar dy herë Gjykata Kushtetuese”, tha Krasniqi. Sipas tij, ndikimi politik dhe real i ngërçit është “fakti që po vazhdon bllokada e nuk po konstituohet Kuvendi dhe rrjedhimisht nuk po arrijmë ta fusim në afate kushtetuese Albin Kurtin për ta dëshmuar atë që e kemi thënë gjithë: ai nuk i ka votat për ta formuar qeverinë”.

MENAXHMENTI I RTK-së: RIORGANIZIMI I STAFIT S'KA KARAKTER NDËSHKUES

PRISHTINË, 28 GUSHT - Menaxhmenti i transmetuesit publik të Kosovës ka hedhur poshtë pretendimet e gjashtë gazetarëve, të cilët thanë se janë larguar nga moderimi i emisioneve dhe e vlerësuan vendimin si “përgjashtim arbitrar dhe censurë alarmante” në Radio Televizionin e Kosovës. Përmes një reagimi, menaxhmenti i Radio Televizionit të Kosovës tha se janë ndërmarrë disa hapa për riorganizimin e stafit, me qëllim të rritjes së cilësisë së përmbajtjes, me fokus forcimin e kanalit informativ RTK3. “Në këtë kuadër janë ndërmarrë disa riorganizime të stafit, të cilat janë vendime të natyrës menaxheriale dhe nuk kanë karakter ndëshkues apo disiplinor. Kontratat e punës së redaktorëve mbeten të paprekura. Detyrat e tyre lidhen me redaktim dhe mbikëqyrje editoriale, jo me moderim, ndaj lirimi i tyre nga ky rol është në përputhje me kontratat dhe rregulloret e brendshme”, u tha në njoftimin e menaxhmentit të RTK-së.

Menaxhmenti i transmetuesit

publik tha se pretendimet për “censurë” apo “heshtje të zërit profesional” nuk qëndrojnë. “Redaktorët vazhdojnë të kenë liri dhe të drejtë të plotë editoriale, të cilën e demonstrojnë përmes paraqitjeve publike në programet e RTK-së, si asnjëherë më parë. Ndonëse RTK aktualisht po funksionon në rrethana jo të zakonshme, kjo gjendje nuk do ta pengojë institucionin në avancimin e ofertës programore dhe përmirësimin e proceseve të punës”, u tha në njoftim. Menaxhmenti i transmetuesit publik tha se gazetarët nuk duhet të shfrytëzojnë situatën nëpër të cilën po kalon RTK-ja për të bërë prononcime në rrjetet sociale me përmbajtje politike, ofenduese, apo të papajtueshme me etikën dhe standardet profesionale. “Po ashtu, çdo deklaram i pabazuar në fakte, që përhap dezinformata duke dëmtuar integritetin e institucionit, nuk do të tolerohet tutje dhe të gjitha këto veprime do të trajtohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret e RTK-së në fuqi”, u

tha në reagim Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës e cilësoi si intimidim ndaj gjashtë gazetarëve të RTK-së njoftimin e lëshuar nga menaxhmenti i transmetuesit publik. “Në një deklaratë gjatë ditës, Menaxhmenti i RTK-së, mes tjerash thotë se ‘çdo deklaram i pabazuar në fakte, që përhap dezinformata duke dëmtuar integritetin e institucionit, nuk do të tolerohet tutje dhe të gjitha këto veprime do të trajtohen në përputhje me ligjin dhe rregulloret e RTK-së në fuqi’”, tha AGK-ja. Sipas Asociacionit, ky është “kërcënim i hapur për masa ndëshkimore ndaj gjashtë redaktorëve që dolën publikisht për të kundërshtuar largimin e tyre arbitrar nga ekrani i transmetuesit Publik”. AGK-ja më 25 gusht e kishte dënuar, po ashtu, atë që e cilësoi si “përgjashtim arbitrar nga ekrani” të gjashtë gazetarëve të RTK-së: Blerta Foniqi Kabashi, Meneta Zekaj Nushi, Arton Mulliqi, Edona Musa Mustafa, Jehona Zhitia dhe Valon Bajrami. “AGK-ja e dënon fuqishëm këtë vendim arbitrar

të menaxhmentit të RTK-së, që paraqet një nivel të paprecedentë të censurës në transmetuesin publik”, tha AGK-ja. Sipas AGK-së këta gjashtë gazetarë “janë ndëshkuar” për punën e tyre “të pandikuar politikisht dhe për ngritjen e zërit për vonesën e pagave”. Të gjashtë gazetarët e RTK-së dolën me një reagim publik më 25 gusht duke kërkuar takim me menaxhmentin e transmetuesit publik, por thanë se nuk kishin marrë përgjigje pse është marrë ky vendim ndaj tyre. “Tendenca është e qartë dhe e shpërfaqur hapur. Këtë e vërteton edhe fakti i paralajmërimeve për heqjen nga skema programore të magazinave informative, sa herë që në këto magazina janë realizuar intervista me të ftuar nga partia në pushtet, të cilët kanë shprehur pakënaqësi nga ballafaqimi profesional”, është thënë në reagim. Ata thanë se ndërhyrja në skemën programore është vendim arbitrar dhe i paligjshëm pasi skema programore mund të ndryshohet vetëm nga bordi,

ndërsa aktualisht RTK nuk ka bord funksional. Të gjashtë gazetarët kanë paralajmëruar se do t'i ndjekin rrugët ligjore për t'i mbrojtur të drejtat e tyre. Javëve të fundit, transmetuesi i vetëm publik në Kosovë u përballë me krizë financiare për shkak të mosalokimit të pjesës së dytë të buxhetit të tij vjetor, si pasojë e moskonstitumit të Kuvendit të Kosovës. Buxheti vjetor i RTK-së kap vlerën e 8.9 milionë eurove, ndërsa këto mjete i ndahen nga Komisioni parlamentar për Buxhet dhe Financa. Më 15 gusht, Qeveria në detyrë e Kosovës njoftoi se kishte miratuar në parim kërkesën e RTK-së për kredi në vlerë prej mbi 2.5 milionë euro, që mundëson ndihmën financiare për transmetuesin deri në konstituimin e Kuvendit. Ndërkaq, ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, Hysen Honduzi njoftoi se pas nënshkrimit të marrëveshjes për huadhënie me Ministrinë e Financave, pagat e korrikut për mbi 700 punëtorët e RTK-së janë ekzekutuar më 22 gusht.



Drejtuesit e OVLUÇK-së takojnë ambasadorin e Bullgarisë, diskutohet për Dhomat e Specializuara

Prishtinë, 28 gusht- Kryetari i OVLUÇK-së, Hysni Gucati dhe nënkryetari i saj Gazmend Sylja, janë takuar me ambasadorin e Bullgarisë në Kosovë, Hristo Kraevski. Ata u pritën në Ambasadën e Bullgarisë. “Gjatë takimit u shpreh mirënjohje për rolin e Bullgarisë në të gjitha

periudhat e rëndësishme për Kosovën, duke filluar nga koha e luftës, pjesëmarrja në misionin paqeruajtës të KFOR-it, e deri te mbështetja për zhvillimin institucional dhe shtetndërtimin. Diskutuam shqetësimet tona lidhur me proceset në Dhomat e Specializuara dhe theksuam

nevojën që këto procese të jenë të drejta, të paanshme dhe të bazuara në të vërtetën. Nga Bullgaria, si mike e Kosovës dhe partnere e besueshme, kërkuam që të përdorë ndikimin e saj për të mbrojtur drejtësinë dhe dinjitetin e luftës sonë çlirimtare”, ka njoftuar OVLUÇK-ja.



BASHA DISTANCOHET NGA ARTIKULLI KUNDËR UÇK-së

Një punim i vitit 2012, në të cilin bashkautor ishte edhe kryetari i ri i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, ka nxitur reagime të shumta në Kosovë. Në punimin me titullin: “Globalizmi në Ballkanin Perëndimor: Krimi transnacional, islami fundamentalist dhe aleancat e padrejta”, thuhej se “sipas rasteve të hetuara, fondet për UÇK-në erdhën nga shqiptarë të zakonshëm në diasporë, por edhe nga trafikantët e drogës që operonin në gjithë Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara”. Pas raportimeve nga mediat për këtë punim, kreu i ri i Kuvendit, Dimal Basha, mohoi se ka shkruar ndonjëherë kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

PRISHTINË, 28 GUSHT (ER) - Kryetari i porsazgjedhur i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, e ka distancuar sërish të enjten veten nga një artikull që flet për ish-Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Në punimin ku ai është bashkautor, thuhet se “sipas rasteve të hetuara, fondet për UÇK-në erdhën nga shqiptarë të zakonshëm në diasporë, por edhe nga trafikantët e drogës që operonin në gjithë Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara”.

Basha gjatë një konference për medie tha se “distancohem nga të gjithë ata që kanë shkruar kundër kësaj vlere”. “Dua të deklaroj me përgjegjësinë më të madhe qytetare dhe kombëtare që kurrë në jetën time nuk është shkruar dhe nuk do të gjendet asnjë përmbajtje që bie ndesh me vlerën e shenjtë të popullit tonë”, tha Basha, duke shtuar se akuzat janë shumë të ulëta. “Unë e kam të shenjtë luftën e UÇK-së, i përulëm çdokujt që ka luftuar. Kurrë në jetën time nuk është shkruar kundër kësaj vlere të popullit. Gjatë këtyre 6 viteve, të ashtuquajturat portale kanë shpifur për mua, duke përdorur burime nga gazetatat e Beogradit duke me sulmuar mua”, ka theksuar Basha.

Një ditë më parë, ai kishte thënë në “Facebook” se kontributi i tij në këtë punim ishte vetëm në Kapitullin 3, “i cili trajton depërtimin e Islamit fundamentalist në Evropën Juglindore, me fokus Kosovën”.

Edhe bashkautorja e këtij punimi, Jana Arsovska, ka mbështetur

pohimin e Bashës. “Thënë shkurt, zoti Basha ka kontribuar vetëm në këtë kapitull, që hulumton përhapjen e islamit radikal në Evropën Juglindore, me fokus të veçantë në Kosovë”, ka thënë ajo për mediat në Kosovë.

Për çfarë punimi bëhet fjalë?

Në punimin me titullin: “Globalizmi në Ballkanin Perëndimor: Krimi transnacional, islami fundamentalist dhe aleancat e padrejta”, thuhej se “sipas rasteve të hetuara, fondet për UÇK-në erdhën nga shqiptarë të zakonshëm në diasporë, por edhe nga trafikantët e drogës që operonin në gjithë Evropën Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara”.

Në punimin e publikuar më 2012 thuhet se përveç se UÇK-ja është “financuar nga trafikantët e drogës”, mbështetja nuk përfshinte vetëm para. “Por, trafikantët e drogës dërguan persona të armatosur për të luftuar së bashku me UÇK-në dhe blinin armë në emër të UÇK-së”. “Teksa lidhja midis UÇK-së dhe krimit të organizuar është e vështirë për t’u matur, ekzistojnë raste gjyqësore të njohura nga Gjermania, Italia, Belgjika dhe Republika Çeke, të cilat sugjerojnë fuqishëm një lidhje midis trafikantëve të drogës dhe UÇK-së”, u tha në këtë punim.

Cilat ishin reagimet?

Organizata e Veteranëve të UÇK-së shprehu “indinjatë për



zgjedhjen e Bashës në krye të Kuvendit”.

“Ky person njihet për qëndrimet e tij denigruese dhe fyese ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke e paraqitur atë si të lidhur me krimin dhe duke njollosur sakrificën më të madhe të popullit tonë. Është e papranueshme dhe e pafalshme që Kuvendi i Kosovës të drejtohet nga një njeri që ka fyer dhe sulmuar UÇK-në dhe dëshmorët tanë”, tha OVLUÇK-ja.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se nëse është dikush që e ka pasur mënyrë jetese demonizimin e UÇK-së dhe të udhëheqësve të saj, ai është Albin Kurti. “Rrjedhimisht, gati secili që i është bashkuar atij, ka pasur ose ka përvetësuar të njëjtin mentalitet. Shembulli i propozimeve nga Lëvizja Vetëvendosje për kryetar të Kuvendit e tregon më së miri: Albulena Haxhiu, Donika Schwartz, Hekuran Murati - të tre me qëndrime dhe veprime kundër UÇK-së dhe trashëgimisë së saj. Njëra duke ua zvogëluar fondet e mbrojtjes në Gjykatën e Hagës, tjetra duke pranuar se ka dorëzuar dosje kundër krerëve të UÇK-së, e tjetri duke përfshirë nga paga minimale kategoritë e luftës çlirimtare dhe duke i fyer luftëtarët e lirisë në krahasimet që ua bënte me mercenarë. Edhe kryekuvendari i ri, me artikullin e

tij morbid kundër UÇK-së, i cili doli dje në pah, vetëm sa e konfirmon filozofinë e Vetëvendosjes: sa më shumë të distancohesh nga UÇK-ja, aq më shpejt ngjitesh në parti. Kjo edhe mund të jetë formula e tyre e brendshme”, ka pohuar Krasniqi. Ai ka thënë se vota e PDK-së nuk ka qenë për individin - por për të mbajtur zotimin e dhënë para qytetarëve, me qëllim të dhënies fund bllokadës institucionale. “Por, edhe për ta zhveshur Vetëvendosjen dhe për ta vënë para reflektorit publik të së vërtetës. Sepse, gjatë janë fshehur e amnistuar prapa Glaukave, por në fakt këta janë Dimala. Nëse ndokush ka pasur dyshime, qoftë edhe brenda elektoratit të tyre, sot besoj e kanë të qartë këtë. Prandaj, turpi i mbetet Vetëvendosjes dhe Albin Kurtit, të cilët me insistim e kandiduan Dimal Bashën. Por, një gjë po vërtetohet edhe tash, siç e kishim thënë në dy herët e kandidimit të tij - ai nuk është i denjë që të jetë Kryetar i Kuvendit. Ndërsa, sa për PDK-në, partinë që e pasoi UÇK-në, pavarësisht gjithçkaje e çdo zhurme, do ta mbrojmë me çdo kusht, si çdo herë tjetër, luftën e UÇK-së dhe shtetin e Kosovës”, ka deklaruar Krasniqi. Ky shkrim ka nxitur edhe reagimin e kryetarit të Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. “Më vjen keq, shumë më vjen

keq, që një shqiptar, për ta publikuar një shkrim, një punim shkencor, vetëm për ta publikuar, për ta mundësuar publikimin e një punimi shkencor, ka fyer, ka ofenduar, ka rrënuar, ka shtrembëruar, ka akuzuar vendin e vet, kombin e vet, për ta botuar një artikull gjoja shkencor, për t’i shërbyer atij vetë personalisht”, ka thënë Limaj, duke shtuar se: “Kjo është shumë serioze”.

Kryetar i Drenasit, Ramiz Lladrovci, publikoi një pjesë të këtij punimi, dhe kërkoi shkarkimin e Bashës. “Kosova jonë kishte dhe ka ‘kontribuues’ si Dimal Basha, por si këto dy faqe që dëshmojnë thellësinë e gënjeshtres, seriozitetin e mashtrimit dhe antikombëtarizmit, nuk mund të gjenden nga autorë shqiptarë”, shkroi Lladrovci në rrjetet sociale. Edhe figura të tjera politike, por edhe të shoqërisë civile reagues me zemërim pas raportimeve për këtë punim.

Dimal Basha u zgjodh në krye të Kuvendit të Kosovës më 26 gusht. Ai ka qenë deputet edhe në legjislaturat e kaluara dhe njihet për gjuhë të vrazhdë kundrejt atyre që i konsideron kundërshtarë.

Ai shpesh ka kritikuar partitë që mandatin e kaluar ishin në opozitë, sistemin e drejtësisë, por edhe mediat.

AGK-ja dënon sulmet ndaj gazetarëve nga kryeparlamentari Basha

Prishtinë, 28 gusht - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) ka dënuar fuqishëm dhe shprehur keqardhje që kryeparlamentari Dimal Basha e ka nisur punën në postin e tij të ri e shumë të rëndësishëm duke sulmuar mediat.

Në një konferencë për medie, Basha ka deklaruar: “Prej 6

vitesh, portalet dhe të ashtuquajtur gazetarë nuk kanë ndaluar së më ofenduari në mënyrat më të ulëta, duke përdorur edhe burime nga gazeta të Beogradit. Mos harroni se keni të njëjtat burime që kanë lobuar për ndarjen e Kosovës dhe për Listën Serbe”.

AGK-ja e dënon fuqishëm këtë gjuhë të papranueshme dhe shumë të rrezikshme të Bashës, e cila është vazhdimësi e sulmeve, ofendimeve dhe akuzave të tij ndër vite ndaj medieve.

AGK-ja e fton Bashën të kuptojë përgjegjësinë që e bart posti i tij i ri, si një prej udhëheqësve

kryesorë të shtetit, dhe të respektojë punën e gazetarëve dhe mediave. “Në vend të sulmeve, zoti Basha duhet të tregojë transparencë për të kaluarën e tij dhe t’u përgjigjet të gjitha pyetjeve e interesimit të mediave për aktivitetin, para se të bëjë kryetar”, thuhet në reagimin e AGK-së.



Trump vendos tarifa prej 50% ndaj Indisë si ndëshkim për blerjen e naftës ruse

UASHINGTON, 28 GUSHT - Donald Trump vendosi tarifa prej 50% për shumicën e importeve amerikane nga India, duke përbushur një kërcënim për të ndëshkuar një nga ekonomitë më të mëdha në botë për blerjet e saj të naftës ruse. Sipas medieve të huaja, tarifat, të cilat hynë në fuqi menjëherë pas mesnatës të së mërkurës në Uashington, rrezikojnë të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në ekonominë indiane dhe të prishin më tej zinxhirët globalë të furnizimit.

Tarifat amerikane prej 25% për mallrat indiane hynë në fuqi në fillim të këtij muaji, por Trump njoftoi plane për të dyfishuar normën, duke përmendur blerjet e naftës ruse nga Nju Delhi, të cilat Shtëpia e Bardhë ka argumentuar se po financojnë në mënyrë indirekte luftën e Rusisë kundër Ukrainës. Presidenti amerikan ka rritur ndjeshëm tarifat amerikane për mallrat nga pjesa më e madhe e botës që nga rihyrja në Shtëpinë e Bardhë në janar, duke tensionuar marrëdhëniet me

ekonomitë e aleatëve dhe rivalëve dhe duke nxitur frikën e inflacionit më të lartë. Ky veprim i fundit i lë eksportuesit indianë të përballen me një ndër detyrimet më të larta të ShBA-së që Trump ka vendosur për mallrat nga jashtë shtetit. Brazili po përballlet gjithashtu me tarifa prej 50% për eksportet e tij në ShBA. Ministrat në Indi argumentojnë se vendi i tyre është veçuar padrejtësisht për marrëdhënien e saj tregtare me Rusinë dhe

zyrtarët paralajmërojnë se vendi ka të ngjarë të punojë më ngushtë me Moskën dhe Pekinin - dhe të largohet më tej nga Uashingtoni. Shumica e eksporteve të mallrave indiane në ShBA (me vlerë 87.3 miliardë dollarë për ShBA-në vitin e kaluar, sipas përfaqësuesit të tregtisë së ShBA-së) tani përballen me detyrime të larta, megjithëse disa produkte kyçe, përfshirë telefonat inteligjentë, do të kursehen, për momentin. Veprimi, i konfirmuar në një



njoftim nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare i ShBA-së në fillim të kësaj jave, i shtyu disa ekonomistë të parashikojnë një rënie të menjëhershme të tregtisë midis dy vendeve.

ÇMIMET E IMPORTIT MË TË LARTA NË TREMUJORIN E DYTË 2025 SESA NË ATË TË 2024



PRISHTINË, 28 GUSHT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e dytë (TM2) 2025, viti bazë 2010=100. Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë pati ngritje për 1,6 % në TM2 2025, krahasuar me TM1 2025. Ndërkaq, krahasuar TM2 2025 me TM2 2024 çmimet e importit u ngritën në një mesatare prej 0,7%.

Tremujori i dytë 2025 - tremujori i parë 2024 1,6 %

Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: lëkura dhe artikujt e saj (19,2%); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale, muzikore dhe mekanizmat e orës (7,5%); artikujt e ndryshëm të prodhuar (4,8%); produktet minerale (3,6%); shtazët e gjalla dhe produktet e shtazëve

(3,0%); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (2,6%); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (2,1%); artikujt ushqimorë të përgatitur, pijet dhe duhani (1,9%); druri dhe artikujt e tij (1,1%); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (1,0%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (0,3%); mjetet e transportit (0,3%); dhe produktet e industrive kimike (0,3%). Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas

sektorëve te: vajrat ushqyese (-2,3%); letra dhe artikujt e saj (-1,0%); tekstili dhe artikujt e tekstilit (-0,8%); produktet bimore (-0,4%) dhe këpucët (-0,3%).

Tremujori i dytë 2025 - tremujori i dytë 2024 0,7%

Çmimet e Importit në Kosovë patën një rritje në një mesatare prej 0,7% ndërmjet TM2 2025 dhe TM2 2024. Ngritje më të

mëdha sipas sektorëve ishin te: shtazët e gjalla dhe produktet e shtazëve (7,2%); lëkura dhe artikujt e saj (6,5%); produktet bimore (3,8%); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (3,3%) etj. Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve te: vajrat ushqyese (-8,3%); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-3,4%); plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (-1,3%); artikujt e ndryshëm të prodhuar (-1,1%); letra dhe artikujt e saj (-0,9%) etj.

Kryetari Latifi vizitoi bodrumet "Labi Wine", sheh suksesin dhe kushtet e operimit

Rahovec, 28 gusht- Bodrumet "Labi Wine", me pronar Labinot Shulina dhe "Canziba Wine", me pronar Selajdin Canziba ishin pikë e ndalesës së kryetarit të Rahovecit,

Smajl Latifi të enjten. Kryetari Latifi pa nga afër kushtet e operimit, dëgjoi nevojat e tyre, por edhe u njoh me sukseset që po shënojnë këto dy bodrume dhe ky sektor në

përgjithësi. "Duke njohur kontributin e tyre si prodhues, eksportues e punëdhënës, ne nuk do të rrimë pa ndërmarrë veprimet e nevojshme që të përmirësohen kushtet përmes

investimeve të nevojshme, për vreshtarët tanë të palodhur dhe verarët e suksesshme të komunës sonë. Faleminderit për pritjen e ngrohtë!", ka shkruar Latifi.



“MARIFETI MË I ZGJUAR QË PREJ KALIT TË TROJËS”: VEPRA SOVJETIKE E ARTIT QË SPIUNOI SHBA-në

Nga: **Matt WILSON** / BBC

Një pajisje përgjimi fshehur brenda një vepre arti, në vitin 1945, mbeti për shtatë vjet e pazbuluar nga siguria amerikane – e ky nuk është shembulli i vetëm kur arti është manipuluar për qëllime të fshehta.

Tetë vjet më parë, gjatë javëve të fundit të Luftës së Dytë Botërore, një grup i vëzhguesve të rinj rusë i dhuruan ambasadorit amerikan në Moskë një Vulë të Madhe të ShBA-së – të gdhendur me dorë, në rezidencën e tij zyrtare në Shtëpinë Spaso. Dhurata simbolizonte bashkëpunimin mes Rusisë dhe ShBA-së gjatë luftës dhe atë ambasadori amerikan W. Averell Harriman e vari me krenari në shtëpinë e tij deri në vitin 1952. Por, pa dijeninë e ambasadorit dhe të ekipit të tij të sigurisë, vula përmbante një pajisje të fshehtë përgjimi, që më vonë nga ekipet amerikane të sigurisë teknike u quajt “Gjëja” (“The Thing”). Krejtësisht e pazbuluar për shtatë vjet, pajisja spiunonte bisedat diplomatike. Duke përdorur një vepër arti që dukej

vënë re nga skanimet e kundërzbulimit, sepse nuk kishte “as elektronikë, as bateri, dhe nuk nxehej”.

Inxhinieria e një instrumenti të tillë ishte po ashtu shumë e përpiktë – “një përzierje mes një ore zvicerane dhe një mikrometri”. Historiani H. Keith Melton ka pohuar se, në kohën e vet, “Gjëja” e ngriti shkencën e përgjimit zanor në nivelin që më parë ishte konsideruar si i pamundur.

Brenda Shtëpisë Spaso, “Gjëja” aktivizohej vetëm kur një marrës-transmetues në distancë, i vendosur në një ndërtesë aty pranë, vihej në punë. Ajo dërgonte një sinjal me frekuencë të lartë, që reflektonte mbrapsht të gjitha vibrimet që vinin nga antena e pajisjes së spiunimit. Vetëm kur një radio-operator ushtarak britanik – i cili punonte në Moskë në vitin 1951 – rastësisht u kyç në të njëjtën gjatësi vale që përdorte “Gjëja” dhe dëgjoi biseda nga një dhomë e largët, pajisja u zbulua. Vitin pasues, teknikët amerikanë kontrolluan rezidencën e ambasadorit dhe – pas jo më pak se tre ditë kërkimesh – kuptuan se vula e madhe e gdhendur e



Një foto bardhë e zi e një burri që mban në dorë Vulën e Madhe të ShBA-së (burimi: Getty Images)

Vulës së Madhe të gdhendur në dru panje.

Dhe, ky nuk është shembulli i vetëm nga historia e artit që është manipuluar për spiunazh, mashtrim dhe strategji ushtarake. Përveç se pikturoi Mona Lizën, Leonardo da Vinci gjithashtu projekttoi tanke dhe armë për rrethim kështjellash, ndërsa Peter Paul Rubens shërbeu si spiun gjatë Luftës Tridhjetëvjeçare. Artistët nga vende të ndryshme, gjatë Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore, hartuan operacione kamuflazhi dhe mashtrimi, ndërsa Anthony Blunt, një historian britanik i artit (dhe kujdestar i Koleksionit Mbretëror të Artit) ishte spiun

sovjetik gjatë gjithë Luftës së Dytë Botërore dhe në fillimet e Luftës së Ftohtë.

Në rastin e çuditshëm të “Gjësë”, edhe historia muzikore është e rëndësishme. Shpikësi i saj i zgjuar, Lev Sergeyevich Termen, i njohur më shumë si Léon Theremin, ishte shpikës me origjinë ruse dhe një muzikant i talentuar. Ai shpiku instrumentin e parë elektronik në botë të njohur – sipas krijuesit të tij – si Theremin. Mund të interpretosh në të pa prekur asgjë – lëvizjet e dorës në ajër rreth antenave kontrollojnë notat. Tingulli i tij i frikshëm u bë sinonim në kolonat zanore të filmave amerikanë të fantashkencës të viteve ‘50 të

shekullit XX – ndoshta më së shumti me filmin Dita kur Toka ndaloi [The Day the Earth Stood Still, 1951] i cili, në mënyrë domethënëse, shpesh përmendet si një alegori për paranojën e Luftës së Ftohtë. Pas zbulimit të saj, “Gjëja” u mbajt sekret nga intelijenca amerikane. Por, në maj të vitit 1960, në kulmin e garës bërthamore, një aeroplan amerikan i spiunazhit, U-2, ra në Rusi. Në trazirat diplomatike që pasuan, zyrtarët e Departamentit të Shtetit të ShBA-së ekspozuan publikisht Vulën e Madhe në një mbledhje të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për të dëshmuar se spiunazhi i Luftës së Ftohtë nuk ishte i njëanshëm. Infiltrimi i rezidencës së një ambasadori ishte një shkelje aq e turpshme sigurie, beson John Little, “saqë duhej rrëzimi i një aeroplani spiunazhi që ‘Gjëja’ të dilte realisht në domenin publik”. Por, mjeshtëria e vërtetë teknike e “Gjësë” nuk iu zbulua kurrë publikut të gjerë.

Prapa dyerve të mbyllura, pajisja u studiuua në detaje nga kundërspiunazhi britanik, që i vuri emrin e koduar SATYR. Dhe, hollësitë e saj mbetën sekret shtetëror derisa ish-oficeri i sigurisë, Peter Wright, i zbuloi të gjithat në kujtimet e tij Gjuetari i spiunëve [Spycatcher] në vitin 1987.

“Gjëja” i ka magjepsur historianët për shkak të sofistikimit teknik që kishte në atë kohë dhe për mënyrën se si e formësoi lojën e spiunazhit gjatë Luftës së Ftohtë. Por, ai gjithashtu zbulon një histori të çuditshme dhe më të errët të kulturës së lartë, që ndodh jashtë shqëlqimit të sallave të operës dhe galerive të artit, ku muzikantët klasikë shpikin pajisje përgjimi, ndërsa veprat e artit të gdhendura me dorë shndërrohen në instrumente për mbledhjen e inteligjencës ushtarake. /Telegrafi/



John Little ndërtoi replikën e tij të “Gjësë” (burimi: John Little)

e padëmshme për të depërtuar tek armiku dhe për të fituar një avantazh strategjik, sovjetikët kishin kryer mashtrimin më të zgjuar që prej Kalit të Trojës së Odisesë. Por, kjo është një histori e vërtetë edhe pse tingëllon si një roman spiunazhi.


Si funksiononte “Gjëja”? John Little, një specialist 79-vjeçar në kundërzbulim, për një kohë të gjatë është magjepsur nga kjo pajisje, madje ka ndërtuar edhe një kopje të saj. Një dokumentar mbi punën e tij të jashtëzakonshme u publikua këtë vit dhe, pas shfaqjes së parë në një sallë të mbushur në maj, pritet të shfaqet më 27 shtator në Muzeun Kombëtar të Informatikës në Parkun Bleçli në Bakingemshër.

Ai e përshkruan teknologjinë e “Gjësë” me terma muzikorë – e përbërë nga tuba si ato të një organoje dhe me një membranë “si lëkura e një daulleje që vibron me zërin e njeriut”. Por, gjithçka ishte futur në një objekt të vogël që dukej si një gjilpërë – me avantazhin që të kalonte pa u



ShBA-së ishte një vesh i padukshëm, që përgjonte diskutimet diplomatike prapa dyerve të mbyllura.

Duke reflektuar mbi suksesin e “Gjësë”, një nga teknikët rusë që e përdori atë, Vadim Goncharov, ka thënë se “për një kohë të gjatë vendi ynë arriti të merrte informacione specifike dhe shumë të rëndësishme që na dhanë disa përparësi ... gjatë Luftës së Ftohtë”. Dhe, deri më sot, askush jashtë shërbimeve sekrete sovjetike nuk e di se sa “Gjëja” të tjera mund të jenë përdorur nga BRSS-ja për të spiunuar Perëndimin në atë kohë.

Por, sukcesi i saj si pajisje përgjimi nuk lidhej vetëm me origjinalitetin teknik. Ajo ishte efektive sepse shfrytëzoi qëndrimet kulturore ndaj objekteve të bukura. Ne kemi prirje t’u besojmë veprave të artit dhe sendeve dekorative si simbole pasive të statusit, shijes ose interesit kulturor. Intelijenca ruse e shndërroi këtë supozim në armë përmes



Shpikësi i “Gjësë”, Léon Theremin, shpiku gjithashtu instrumentin e parë elektronik në botë (burimi: Getty Images)



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Imanov dhe Hetemi përforcojnë Malishevën

MALISHEVË, 28 GUSHT - Skuadra e Malishevës ka realizuar dy transferime në 24 orët e fundit. Bëhet fjalë për portierin Yusif Imanov dhe mesfushorin Rilind Hetemi. Klubi malishevas beson se portieri i Kombëtares së Azerbajxhanit do t'i jep edhe më shumë siguri portës së tyre. "FC Malisheva njofton se ka arritur marrëveshje për transferimin e portierit të

kombëtares së Azerbajxhanit, Yusif Imanov. Reprezentuesi i Azerbajxhanit transferohet nga Sabah FK, aty ku u paraqit me mjaft sukses në kampionatin nacional të Azerbajxhanit, si dhe në garat evropiane poashtu. Imanov është 22-vjeçar, ka cilësi dhe potencial, andaj besojmë se i kemi dhënë edhe më shumë siguri portës sonë, bashkë me portierët që

kemi! Ky është një tjetër hap drejt ndërtimit të projektit afatgjatë, stabil dhe me objektiva të qarta", thuhet në njoftimin e Malishevës. Ndërsa mesfushori Hetemi është zhvilluar në akademinë e Borussia Dortmundit. Malisheva beson se mesfushori do t'i jep me shumë kreativitet dhe do të shtojë cilësinë e lojës. "Ju prezantojmë një tjetër

ardhje të këtij afati kalimtar, behët fjalë për mesfushorin, Rilind Hetemi. Rilindi është zhvilluar në akademinë e Borussia Dortmund, në Gjermani. Ndërsa vije për të vazhduar rritjen e tij, si dhe për të ndihmuar klubin drejt objektivave të këtij sezoni. Me Rilindin, repartit tonë të mesfushës i japim edhe më shumë kreativitet, konkurrencë



dhe cilësi", thuhet ndër të tjera në njoftimin në fjalë.

| "Epoka e re"

TRAJNER I ZVICRËS: JEMI TË ZHGËNJYER SE LEON AVDULLAHU E ZGJODHI KOSOVËN

"Epoka e re"

CYRIH, 28 GUSHT - Leon Avdullahu ditë me parë vendosi të përfaqësojë Kosovën në vend të Zvicrës, kurse këtë vendim e ka komentuar të enjten përzgjedhësi "Helvetik", Murat Yakin. Ylli i ri i Hoffenheimit u kritikua nga vendimi i tij në Zvicër, aty ku u lind e u rrit, dhe ku luajti në ekipet zinxhir të Zvicrës. "Sa e di unë, kemi punuar fort për të gjatë pranverës. Natyrisht, me kalimin në Bundesligë, tash i ka synimet dhe pritshmëritë e veta. E kam

një ndjenjë që nuk ishte e lehtë për të. Duhet ta pranojmë faktin se ka vendosur ta ndërrojë Kombëtaren. Natyrisht, është një zhgënjim për ne, për të të ardhur keq që ka ndodhur kjo. Interpretimi im është se ai ka konkurrencë të madhe në mesfushë (tek Zvicra) dhe ka dëshirë të luajë menjëherë (tek Kosova)", ka thënë Yakin. "E pata një bisedë të gjatë me të në pranverë dhe ia shpjegova perspektivat sportive. Siç e shoh unë, ai nuk e ka zgjedhur rrugën sportive. Nëse dikush ndihet ndryshe për kulturën, ne nuk mund të ndikojmë këtu", ka

shtuar Yakin. Përzgjedhësi i Zvicrës foli edhe për mbrojtësin Alban Hajdari, i cili mund ta ndjekë rrugën e Leon Avdullahut për t'iu bashkuar Kosovës. Yakin ka thënë se Federata e Futbollit të Zvicrës është duke punuar në këtë drejtim, por që nuk ka dashur ta ftojë për ndeshjet e shtatorit pasi lojtari së fundmi u bë me ekip të ri duke u transferuar në Hoffenheim. "Nuk e përfshimë në ndeshjet e shtatorit, për këtë kemi rënë dakord. E kemi një plan për të, por do ta trajtojmë këtë pas ndeshjeve të shtatorit", u shpreh Yakin.



ZVICRA FTON XHAKËN DHE JASHARIN PËR NDESHJEN NDAJ KOSOVËS



BASEL, 28 GUSHT - Federata e Zvicrës ka shpallur listën me 23 lojtarë të ftuar për ndeshjen e parë të kualifikueseve të Botërorit 2026 kundër Kosovës, e cila do të luhet më 5 shtator, në "St. Jakob-Park" të Baselit. Përballja pritet me interes të madh, jo vetëm për rivalitetin sportiv, por edhe për lidhjet e forta që ekzistojnë mes dy përfaqësuesve. Në listën e publikuar nga trajneri Murat Yakin, spikasin dy emra të njohur me origjinë shqiptare: Granit Xhaka, kapiteni dhe një nga shtyllat kryesore të helvetikëve, si dhe Ardon Jashari, mesfushori i ri që shihet

si pjesë e së ardhmes së skuadrës zvicerane. Megjithatë, mungojnë dy futbollistë të tjerë që kanë qenë shpesh në qendër të diskutimeve. Uran Bislimi, i cili refuzoi Kosovën për t'u veshur me fanellën e Zvicrës, nuk është përfshirë këtë herë. Po ashtu, mbrojtësi Alban Hajdari, që mbetet ende mes dy zgjedhjeve, Kosovë apo Zvicër, nuk është grumbulluar. Kjo situatë tregon edhe një herë për përzierjen e historive dhe identiteteve në skuadrën helvetike, ku futbollistët me origjinë shqiptare kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një rol të rëndësishëm. Përballja

Zvicër-Kosovë pritet të jetë më shumë se një ndeshje futboll: një sfidë me ngarkesë emocionale të veçantë, ku futbollistët me rrënjë të përbashkëta do të gjenden në dy kampe të ndryshme.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

G.Kobel, M.Keller, Y.Mvogo, M.Akanji, A.Amenda, N.Elvedi, M.Muheim, R.Rodriguez, I.Schmidt, S.Widmer, B.Embolo, R.Freuler, C.Itten, A.Jashari, J.Manzambi, J.Monteiro, D.Ndoye, F.Rieder, V.Sierro, S.Sohm, R.Vargas, G.Xhaka, D.Zakaria.

Dren Dedushaj, lojtar i ri i Vëllaznimit

GJAKOVË, 28 GUSHT - KB Vëllaznimi është përforcuar me basketbollistin e njohur Dren Dedushaj. Para transferimit në skuadrën gjakovare, Dedushaj ka bërë karrierë edhe në ShBA,

kurse në Kosovë ka luajtur për Prishtinën dhe Bashkimin. "Dren Dedushaj është lojtari më i ri i ekipit tonë. Lojtari i gjatë 218 centimetra, karrierën e tij e nisi në SHBA, ku për dy sezone ishte

pjesë e kolegjit Bryant Bulldogs (NCAA). Pas kthimit në Kosovë, ai u bashkua me Sigal Prishtinën, ku qëndroi dy edicione rresht, ndërsa dy sezonet e fundit i kaloi te

Bashkimi i Prizrenit. Tash, Dedushaj vjen në Gjakovë për të forcuar radhët e skuadrës kuqezi, duke i dëshiruar mirëseardhje dhe suksese!", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.



Mourinho, jashtë Ligës së Kampionëve: Tani synojmë trofeun në Ligën e Evropës

STAMBOLL, 28 GUSHT - Jose Mourinho u përball me eliminimin nga Liga e Kampionëve në ndeshjen e kthimit të “play-off”-it kundër Benficas, pas humbjes 1-0 në “Estadio da Luz”. Duke folur pas ndeshjes, trajneri i Fenerbahçes pranoi: “Në pjesën e parë Benfica nuk ishte vetëm më e mirë, ishte shumë

më e mirë. Në pjesën e dytë ishim ne që luajtëm më mirë, por jo shumë. Krijua dy raste të rëndësishme në këtë fazë të fundit, pastaj kartoni i kuq e ndërpreu epërsinë tonë. Duke parë ndeshjen në tërësi, fitoi skuadra më e fortë”. Lidhur me Talisca dhe jo Duran, ka shtuar: “Jhon nuk ishte mirë

fizikisht, pati probleme dhe u stërvit pak. Talisca është lojtar me një lloj tjetër personaliteti, luan më mirë mes linjave. Ne kërkuam të kishim më shumë zotërim topi në pjesën e parë, por ia dolëm vetëm në të dytën. Nuk më pëlqen të gjej justifikime për gjëra që nuk kanë. Skuadra më e fortë, me lojtarët më të mirë dhe më me

përvojë, fitoi dhe e meritoi”. Së fundi, Mourinho reflektoi mbi ndikimin që mund të ketë kjo dalje nga Liga e Kampionëve në fillimin e sezonit për Fenerbahçen e tij: “Nëse do të shkonim në Ligën e Kampionëve do të kishim luajtur ndoshta 8 ndeshje, në Ligën e Evropës synimi është trofeu”.



Jashari: Milani meriton të jetë në majë, humbja na tregoi rrugën e vështirë

Milano, 28 gusht - Debutimi në Serie A nuk ishte ajo që ëndërronte Ardon Jashari, i cili përjetoi humbjen zhgënjyese ndaj Cremoneses. Megjithatë, mesfushori i ri i Milanit e sheh këtë nisje si një mësim të vlefshëm: “Është gjithmonë e rëndësishme të fillosh mirë, sidomos në një klub të madh si Milani. Ndoshta është më mirë që kjo humbje erdhi që në javën e parë, sepse e kuptojmë menjëherë sa e vështirë do të jetë. Për disa nuk është diçka e re, por për të gjithë ishte një lloj zgjimi”. Një nga emocionet më të mëdha të tij është të ndajë fushën me Luka Modriqin, një kampion që sipas Jasharit bën diferencën brenda dhe jashtë fushe: “Është diçka e veçantë të luash pranë tij. Ne e shijojmë praninë e Modriqit dhe kemi



shumë për të mësuar nga ai”. Sa u përket objektivave, Jashari

thekson se fjala “Champions” nuk përmendet shpesh brenda grupit, por të gjithë e dinë qartë qëllimin: “Milani duhet të jetë në krye të renditjes. Nëse fitojmë sa më shumë ndeshje, atëherë edhe Liga e Kampionëve do të vijë vetvetiu”. I pyetur për stilin e tij të lojës, 21-vjeçari tregon filozofinë që e udhëheq: “Jam një lojtar që dua gjithmonë të fitoj dhe të përmirësohem, qoftë si individ, qoftë si pjesë e skuadrës. Dua që shokët të kenë besim tek unë në çdo situatë, me topin apo në aspektin taktik”. “Mund të luaj si numër 6 ose 8, sipas kërkesës së trajnerit. Për mua nuk ka rëndësi pozicioni, por çfarë kërkon trajneri. Jam i bindur se mund ta ndihmoj skuadrën si në fazën mbrojtëse, ashtu edhe në atë ofensive”, ka deklaruar Jashari.

Amorim pas eliminimit turpërues: Më falni, por nuk mund të ndryshoj 22 lojtarë

MANCHESTER, 28 GUSHT - Manchester United përjetoi një tjetër humbje zhgënjyese, duke u eliminuar në raundin e dytë të Carabao Cup nga skuadra modeste e Grimsby Town, që luan në kategorinë e katërt të futbollit anglez. “Djajtë e Kuq” barazuan 2-2 në minutat e fundit, por u dorëzuan pas një maratone penalltish, duke humbur 12-11. Pas ndeshjes, trajneri Ruben Amorim foli me tone të ashpra, duke pranuar se ekipi po kalon një moment shumë të vështirë. “Jam i shokuar, sepse jemi në një moment ku po bëjmë shumë ndryshime dhe po përpiqemi të luftojmë në disa drejtime. Por kur përballesh me situata të tilla, duhet të tregosh karakter. Nëse nuk e bëjmë, diçka duhet të ndryshojë. Por nuk mund të ndryshojmë sërish 22 lojtarë”, ka thënë Amorim për ITV. Unitedi nuk ka fituar asnjë nga tre ndeshjet e para të sezonit,



pavarësisht afrimeve të bujshme në merkato si Benjamin Sesko, Matheus Cunha dhe Bryan Mbeumo, të cilët ishin të gjithë në fushë ndaj Grimsby. Tani presioni mbi Amorimin është në rritje, me ndeshjen ndaj Burnley, të shtunën në “Old Trafford”, që pritet të jetë një test kritik. Portieri Andre Onana, në paraqitjen e tij të parë këtë sezon, gaboi në të dy golat e pësuar. Megjithatë, Amorim refuzoi ta fajësonte vetëm portierin: “Me gjithë respektin, kur luan kundër një skuadre të kategorisë së

katërt, problemi nuk është vetëm portieri. Është gjithçka: mjedisi, mënyra si e përballojmë garën. Sot ekipi foli qartë në fushë – dhe nuk më pëlqeu ajo që dëgjova”. Trajneri portugez ka thënë se mesazhi që dhënë ekipi në fushë ishte “i qartë” dhe nuk kishte nevojë për shpjegime të mëtejshme: “Është shumë e qartë ajo që ata treguan sot. Mënyra si e nisëm ndeshjen, pa asnjë intensitet, pa zbatim të ideve të presionit ... u dukëm të humbur. Kur humbet dhe sheh diçka të re, është ndryshe, por sot nuk pashë asgjë. Dua vetëm të kërkoj falje nga tifozët, sepse ata janë gjithmonë pranë nesh, edhe pas çdo humbjeje”. Amorim mbylli deklaratën me një ton vetëkritik, duke premtuar analiza të thella gjatë pushimit dyjavor që vjen: “Kemi një ndeshje këtë fundjavë dhe më pas dy javë pushim. Do t'i zgjidhim gjërat. Por sot, e vetmja gjë që mund të them është ‘më falni’.”

SHKURT

Xhudistët e Kosovës stërviten në Francë

Ekipi i meshkujve të Federatës së Xhudos së Kosovës po stërvitet në Bordo të Francës. Ekipi i meshkujve, nën udhëheqjen e Nora Gjakovës si asistente trajnere, e cila i është bashkuar stafit të trajnerëve me plot energji dhe përkushtim, po stërviten për garat e radhës në shtetin francez. Federata e Xhudos ka njoftuar se me shumë vullnet dhe përkushtim për sukses, xhudistët Akil Gjakova, Shpati Zekaj, Dardan Cena dhe Anes Veseli po japin maksimumin në çdo stërvitje, duke u përgatitur për garat e rëndësishme të shtatorit dhe tutje që po afrohen. “Krenarë për punën e tyre të palodhur dhe për vendosmërinë e tyre për të arritur sukses”, thuhet në njoftimin e FXhK-së.

Ndryshon orari i finales së Ligës së Kampionëve

Pak orë para shortit të sezonit të ri në Ligën e Kampionëve, arrin një komunikatë e rëndësishme nga ana e UEFA-s që i përket finales së kompeticionit, e cila këtë herë do të luhet në Budapest. Më specifikisht, do të ndryshojë orari i fillimit të finales, që do të zhvendoset nga ora 21:00 në 18:00. Vetë UEFA e ka shpjeguar kështu zgjedhjen e saj: “Vendimi është marrë për ta përmirësuar përvojën e përgjithshme të ditës së ndeshjes për tifozët, si dhe për ekipet dhe qytetet pritëse, duke e optimizuar logistikën dhe operacionet. Qëllimi është që dita e ndeshjes të jetë një përvojë për të gjithë ata që dëshirojnë të marrin pjesë, duke e krijuar një atmosferë të arritshme për familjet dhe fëmijët. Për tifozët mysafirë, kjo do të thotë akses më i mirë në transportin publik, veçanërisht pas ndeshjes dhe një kthim më të sigurt dhe më të përballueshëm nga stadiumi. Për qytetet pritëse, kjo do ta rrisë ndikimin ekonomik duke u dhënë tifozëve mundësinë për t'i vazhduar festimet”, ka njoftuar shtëpia e futbollit evropian.

Asllani zgjedh fanellën me numrin 32

Kristjan Asllani është tashmë zyrtarisht pjesë e Torinos. Klubi italian ka publikuar një video ekskluzive që tregon ditën e tij të parë si futbollist i “granatave”, duke dokumentuar të gjitha momentet e para të aventurës së tij të re. Mesfushori shqiptar nisi ditën me zgjedhjen e numrit të fanellës së re, duke shpjeguar me humor arsyen e zgjedhjes së tij: “Pse numri 32? Sepse thujasë të gjitha ishin të zënë. (qesh) Doja 23, por ishte i zënë. Edhe 44 e kishte Ismajli. Ndaj mora 32, që është e kundërta e 23”. Videoja e klubit tregon gjithashtu momentet e vizitave mjekësore, një tur të ambienteve stërvitore dhe zyrave të klubit, për të përfunduar me nënshkrimin e kontratës së re. Asllani pritet të jetë menjëherë në dispozicion të trajnerit të Torinos për ndeshjet e para të sezonit në Serie A.

Messi ende i pavendosur për pjesëmarrjen në Kupën e Botës 2026

Sulmuesi Lionel Messi ende nuk e ka konfirmuar nëse do të marrë pjesë në Kupën e Botës 2026 me Kombëtaren e Argentinës. Sipas mediumit Ole, aktualisht nuk ka asnjë garanci se argentinasi 38-

vjeçar do të luajë në turneun më të madh në botë për kombëtare. Messi preferon t'i marrë gjërat “nga dita në ditë” dhe aktualisht është i përqendruar në ndeshjen kualifikuese të Argentinës për

Kupën e Botës kundër Venezuelës më 5 shtator. Njerëzit pranë Messit kanë lënë të kuptohet se vendimi do të merret gradualisht. “Do të jetë një vendim shumë personal dhe ai do ta marrë

kur të ndihet gati”, thanë burimet Messit. Për momentin, të gjitha shenjat tregojnë se Messi do të marrë pjesë në Kupën e Botës 2026, e cila do të mbahet në ShBA, Kanada dhe Meksikë. Si

trajneri i Argentinës, Lionel Scaloni, ashtu edhe presidenti i FIFA-s, Gianni Infantino, janë të bindur se ai do të luajë, dhe thuhet se edhe ish-presidenti i ShBA-së, Donald Trump, e mbështet këtë ide.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Kalaja” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810246159 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Kalaja” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810246159 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Kalaja” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810246159 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM MBI ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË " Capital Alliance Investment Advisory" L.L.C.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë dhe të Marreveshjes dhe Statutit se Shoqërisë, të plotësuar dhe ndryshuara, Kuvendi i Aksionareve të shoqërisë “Capital Alliance Investment Advisory” L.L.C., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me numër unik identifikues 811300607 (“Shoqëria”) ka nxjerr:

VENDIM PËR ZVOGËLIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË me datë 27.08..2025

Kapitali i shoqërisë zvogëlohet nga nga vlera e regjistruar **1,554,387.62 Euro në 61,850.00 Euro**

Të gjithë Kreditorët e Shoqërisë kanë të drejtën që në afatin 21 ditor nga dita e publikimit të këtij njoftimi në shtypin ditor ti drejtohen Shoqërisë me kërkesë për siguri shtesë ose kërkesë për mos-zvogëlim të kapitalit. Kërkesat i drejtohen Shoqërisë përmes postës së rregullt në adresën:

“Capital Alliance Investment Advisory” L.L.C., me seli në Prishtinë, Rr. Anton Çetta nr.23



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Kadri Thaqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 të banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të

volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka

një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8, 10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.3716 i dt. 28.08.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 29.08.2025 shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

Pozita e punës: Asistent i Zëvendës Kryeshefit Ekzekutiv
Numri i pozitave: 1 (një)
Niveli i Pagës: XI
Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar
Kualifikimet:Diplomë Universitare
Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune
Puna provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë: Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, [në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.](#)

Përgatitja profesionale:

- Diplomë Universitare;
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **29.08.2025** dhe përfundon më datë **12.09.2025** në ora **24:00**.
Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **14.11.2025**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 29.08.2025



Në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ nr.01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Rregullores nr.4417 të datës 04.12.2024 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës, nenit 8, 10 dhe nenit 12 të Rregullores nr.4074 të datës 31.10.2024 mbi Marrëdhënien në Punë dhe Vendimi nr.3725 i dt. 28.08.2025, NPK "Trafiku Urban" SHA.- Prishtinë, më datë 29.08.2025shpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

Pozita e punës: Auto-Elektricitist
Numri i pozitave: 3 (tre)
Niveli i Pagës: XII
Kohëzgjatja e kontratës: Në afat të pacaktuar
Kualifikimet:Shkollim profesional nga fusha e auto elektrikes
Përvoja e punës: 1 vit përvojë pune
Puna provuese: 3 muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë: Në lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë e punës mund të informoheni përmes web: www.trafikurban-pr.com, [në vegzën- Rreth Nesh, Raporte/Rregullore.](#)

Përgatitja profesionale:

- Diplomë e shkollës së mesëm (Shkollim profesional nga fusha e auto elektrikes);
- 1 vit përvojë pune;
- Aftësi të mira organizative dhe komunikuese;
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://trafikurban-pr.com> në vegzën - Konkurse/Aplikacioni për punë, (Aplikacioni duhet të jetë i nënshkruar nga kandidati në të kundërtën nuk do të pranohet)
- CV
- Dëshmi mbi shkollimin;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Certifikatën mbi dënimin penal nga gjykata kompetente që kandidati nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale me dashje (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Kopje të certifikatave të tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi.

Çdo përgënjeshttrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim materiali nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

Të drejtë aplikimi në këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com
Konkursi është i hapur nga data **29.08.2025** dhe përfundon më datë **12.09.2025** në ora **24:00**.
Kalendari i përafërt i zhvillimit të procedurave: Pas përfundimit të procedurave të hapjes së konkursit procedurat zhvillimore planifikohet që të përfundojnë më së largu deri më **14.11.2025**.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 20 pikë
- CV – maksimumi 10 pikë

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 29.08.2025



